

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË CONSULTING GROUP

Neni 1

Themelimi dhe Emërtimi

Sot, më 10 Janar 2022, nëpërmjet këtij akti dhe bazuar në Ligjin 9901 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" themelon një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë, të emërtuar "**Consulting Group**".

Themeluesit e shoqërisë janë:

- **Mirela Arqimandriti**, shtetas shqiptar, me numër identifikimi G758170870, banues në Tiranë.

Shoqëria emërtohet: "**Consulting Group**" (në vijim referuar si "**Shoqëria**").

Neni 2

Forma Juridike

"**Consulting Group**". është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe organizuar në përputhje me dispozitat e ligjit no. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, të ndryshuar dhe në përputhje me këtë akt.

Neni 3

Selia

- 3.1. Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: Rr. "*Abdyl Frasheri*" Pallati 10/1, shk.1, ap.3, Tiranë, Shqipëri".
- 3.2. Administratori/ët mund të hapë/in dhe/ose mbyllë/in degë dhe/ose zyra përfaqësimi, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 4

Kohëzgjatja

- 4.1. Shoqëria ushtron aktivitetin e saj për një afat të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar, të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit.
- 4.2. Prishja dhe likuidimi i Shoqërisë do të përcaktohen me vendim të Ortakut të Vetëm, në përputhje me dispozitat e këtij Statuti dhe legjislacionit në fuqi.

Neni 5

Objekti i Veprimtarisë

- 5.1. Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë, por nuk do të kufizohet në:
 - i. Shërbime të përgjithshme të konsulencës;
 - ii. Shërbime të hartimit, përgatitjes dhe zbatimit të programeve dhe projekteve të zhvillimit;
 - iii. Shërbime të konsulencës menaxheriale, financiare dhe ligjore, të ndërmjetësimit dhe bashkëpunimit, të burimeve njerëzore dhe të marketingut;
 - iv. Realizim i analizave, sondazheve dhe kërkimeve të tregut, kombëtare dhe ndërkombëtare, vlerësimeve ekonomike, sociale, mjedisore dhe infrastrukturore;

- v. Shërbime të lidhura me organizimin e eventeve, seminareve, konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare;
 - vi. Projektim, zhvillim i projekteve të investimit, kolaudim dhe zbatime të projekteve.
 - vii. Cdo aktivitet i dobishëm apo i nevojshëm për përmbushjen e objektivave të shoqërisë si aktivitete tregtare, financiare etj.
- 5.2.** Në përputhje me legjislacionin shqiptar, në mënyrë që të realizohet objekti i mësipërm i veprimtarisë, Shoqëria mund të kryejë:
- (i) cdo transaksion lidhur me prona të luajtshme dhe të paluajtshme;
 - (ii) cdo aktivitet tregtar, financiar, dhënie me qira apo hipotekor.
- 5.3.** Shoqëria, me qëllimin për të investuar në kapital, mund të ketë interesa dhe marrë pjesë në shoqëri të tjera, konsortiume etj., që kanë objekte veprimtarie të cdo lloji, të ngjashme me objektin e veprimtarisë së saj.
- 5.4.** Pavarësisht sa më sipër, Shoqëria mund të kryejë cdo aktivitet të nevojshëm apo të dobishëm të lejuar nga ligji për realizimin e objektit të saj të veprimtarisë.

Neni 6

Kapitali

- 6.1.** Kapitali i Shoqërisë është 10000 (dhjetë mijë) lekë.
- 6.2.** Kapitali i Shoqërisë përbëhet nga 1 (një) kuotë, me vlerën nominale prej 10000 (dhjetë mijë) lekë.

Neni 7

Ortaku i Vetëm

Ortaku i Vetëm i Shoqërisë është:

- **Mirela Arqimandriti**, shtetas shqiptar, me numër identifikimi G758170870, banues në Tiranë, zotërues i 1 (një) kuote që i korrespondon 100% të kapitalit themeltar në shumën prej 10.000,00 (dhjetë mijë) lekë.

Neni 8

Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit

- 8.1.** Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet në çdo kohë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me vendim të Ortakut të Vetëm.
- 8.2.** Shoqëria në çdo kohë mund të zvogëlojë kapitalin me vendim të Ortakut të Vetëm. Në çdo rast, kapitali nuk mund të zvogëlohet nën minimumin e 100 (njëqind) lekë, që është minimumi i vlerës së kërkuar nga ligji.

Neni 9

Transferimi i Kuotës

Ortaku i Vetëm mund të vendosë në çdo kohë për pjesëtimin dhe transferimin e kuotës përmes shitjes, dhurimit, apo ndonjë mënyre tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

Neni 10

Vendimmarrja

- 10.1.** Organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë është Ortaku i Vetëm.

- 10.2.** Ortaku i Vetëm është përgjegjës, ndër të tjera, për vendime në lidhje me çështjet e mëposhtme:
- i. përcaktimin e politikave të biznesit të Shoqërisë;
 - ii. ndryshimin, modifikimin, plotësimin e statutit;
 - iii. emërimin dhe shkarkimin e administratorëve, vendosjen dhe ndarjen e kompetencave të tyre, si dhe shpërblimin përkatës;
 - iv. zmadhimin dhe/ose zvogëlimin e kapitalit;
 - v. transferimin e kuotave;
 - vi. shpërndarjen e fitimeve;
 - vii. riorganizimin, prishjen dhe/ose likuidimin e Shoqërisë; dhe
 - viii. çdo çështje tjetër të parashikuar nga legjislacioni i zbatueshëm dhe ky Statut.

Neni 11

Regjistri i Vendimeve

- 11.1.** Të gjitha vendimet e marra nga Ortaku i Vetëm regjistrohen në Regjistrin e Vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet të regjistrohen në veçanti, vendimet e mëposhtme:
- i. miratimi i pasqyrave financiare dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
 - ii. shpërndarja e fitimeve dhe humbjeve;
 - iii. zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit themeltar;
 - iv. vendime në lidhje me investimet;
 - v. riorganizimi dhe prishja e Shoqërisë.
- 11.2.** Lista e mësipërme nuk është shteruese. Dhe vendimet të cilat nuk regjistrohen në Regjistrin e Vendimeve, do të konsiderohen të pavlefshme.

Neni 12

Administrimi

- 12.1.** Shoqëria mund të administrohet nga një apo disa administratorë.
- 12.2.** Administratori i parë i Shoqërisë është:
- **Mirela Arqimandriti**, shtetas shqiptar, e bija e Fatoshit, lindur në **Vlorë, më 17 Gusht 1967**, madhor, me aftësi të plotë juridike, me Nr Identifikimi G758170870;
- 12.3.** Administratori/ët do të emërohen me vendim të Ortakut të Vetëm dhe mund të shkarkohen në çdo kohë me një vendim të njëjtë.
- 12.4.** Kompetencat specifike të secilit Administrator do të vendosen me vendim të Ortakut të Vetëm dhe mund të ndryshohen në të njëjtën mënyrë.
- 12.5.** Administratorët janë persona fizikë, pa ndonjë kufizim në lidhje me shtetësinë. Kohëzgjatja e mandatit të Administratorit/ëve do të vendoset në momentin e emërimit, por në çdo rast nuk mund të tejkalojë afatin 5 (pesë) vjeçar. Pavarësisht këtij kufizimi, kohëzgjatja e mandatit të administratorit mund të ripërtërihet me anë të vendimit të Ortakut të Vetëm, pa kufizim.

Neni 13

Kompetencat e Administratorit

- 13.1.** Administratori është përgjegjës për administrimin e Shoqërisë dhe përfaqëson Shoqërinë me palët e treta, në përputhje me dispozitat e këtij Statuti dhe legjislacionin e zbatueshëm.

- 13.2.** Kompetencat dhe detyrat e administratorit në lidhje me administrimin dhe mbikëqyrjen e aktivitetit të Shoqërisë përfshijnë, por nuk do të kufizohen në:
- i. zbatimin e politikave të biznesit të Shoqërisë dhe vendimet e Ortakut të Vetëm;
 - ii. sigurimin e përputhshmërisë me legjislacionin dhe standardet e kontabilitetit nga Shoqëria;
 - iii. kryerjen e të gjitha veprimeve lidhur me administrimin e veprimtarisë së Shoqërisë;
 - iv. sigurimin e mbajtjes së rregullt të dokumenteve financiare dhe kontabël të Shoqërisë;
 - v. përfaqësimin e Shoqërisë me palët e treta;
 - vi. kryerjen e të gjitha regjistrimeve dhe publikimeve të detyrueshme në lidhje me Shoqërinë, që kërkohen sipas legjislacionit në fuqi;
 - vii. kryerjen e detyrave të tjera të parashikuara në legjislacionin e zbatueshëm dhe në këtë Statut.
- 13.3.** Administratori mund të ushtrojë të gjitha kompetencat dhe veprimet, me përjashtim të atyre që me ligj dhe nga ky Statut janë të rezervuara për Ortakun e Vetëm.
- 13.4.** Kompetencat e Administratorit mund të vendosen me vendim të Ortakut të Vetëm dhe mund të modifikohen në të njëjtën mënyrë.
- 13.5.** Në kushtet kur shoqëria ka 2 administratorë të gjitha vendimet mund të bashkë-nënshkruhen nga 2 (dy) Administratorë në mënyrë që të jenë të vlefshme dhe angazhojnë Shoqërinë.
- 13.6.** Administratorët mund të delegojë një pjesë ose të gjitha kompetencat e tij tek persona të tjerë.

Neni 14

Audituesi ligjor

Nëse kërkohet me ligj ose miratohet nga Ortaku i Vetëm, kontrolli i pasqyrave financiare dhe të dhënave kontabël të Shoqërisë do t'u besohet një ose me shumë ekspertëve kontabël të autorizuar.

Neni 15

Viti Financiar dhe Pasqyrat Financiare

- 15.1.** Viti ushtrimor fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti.
- 15.2.** Viti i parë ushtrimor fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe përfundon më 31 dhjetor 2021.
- 15.3.** Pasqyrat financiare vjetore, inventari, raporti i Administratorit dhe audituesit ligjor të autorizuar, nëse ka një të tillë, miratohen nga Ortaku i Vetëm në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*", i ndryshuar.
- 15.4.** Miratimi i dokumenteve lidhur me pasqyrat financiare do të kryhet çdo vit, brenda 6 (gjastë) muajve nga përfundimi i vitit ushtrimor.

Neni 16

Prishja dhe Likuidimi i Shoqërisë

- 16.1.** Ortaku i Vetëm mund të vendosë për prishjen e Shoqërisë. Prishja e Shoqërisë do të shoqërohet me procedurën e likuidimit të saj.
- 16.2.** Ortaku i Vetëm emëron një ose më shumë likuidues, duke përcaktuar tagrat e tyre në përputhje me


- 16.3. Shoqëria vazhdon të ekzistojë si person juridik për nevoja të likuidimit deri në përfundim të këtij procesi. Gjate kësaj procedure, togfjalëshi “*në likuidim e sipër*” duhet të vihet pas emrit të Shoqërisë.

Neni 17

Ligji i Zbatueshëm dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

- 17.1. Ky akt bazohet ne legjislacionin shqiptar dhe interpretimi, vlefshmëria dhe zbatimi i tij, duhet të kryhen në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar. Dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar do të zbatohet për çështjet që nuk rregullohen nga ky dokument.
- 17.2. Mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e këtij akti do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës.

ORTAKU I VETËM
Mirela Arqimandriti



Emër Mbiemër
(Nënshkrimi)

